

Fjalimi i Arqipeshkvit Metropolit Imzot George A. Frendo, O.P

Kisha Katolike e Shqipërisë

11 qershor 2019

Fetë janë për paqe

Në parim, feja i shërben paqes. Nëse ndonjë fe i shërben nxitjes së trazirave, racizmit, padrejtësive ose diskriminimit, atëherë ajo nuk mund të quhet një fe e vërtetë, por një kopje e shëmtuar e saj.

Nga ana tjetër, ne duhet të kemi parasysh që paqja nuk është diçka që fitohet automatikisht. Paqja nuk është gjendje amullie, por as thjesht mungesa e luftës. Nëse kjo do të ishte çështja, atëherë vendi që do të meritonte më së miri titullin “strehëza e paqes” do të ishin varrezat: të vdekurit nuk janë asnjëherë në luftë me njëri tjetrin. Por, guxoj të them se ne duhet të “luftojmë” për paqen. Sado paradoksale apo edhe absurde të duket kjo fjali, kjo është e vërteta! Paqja kërkon të jemi të përkushtuar për t’i tejkaluar të gjitha ato elemente apo situata të cilat pengojnë ndërtimin e paqes.

Në letrën e tij kushtuar Efesianëve, Shën Pali shpreh një pohim interesant: “Vetë [Krishti] është paqja jonë, i cili i bëri dy grupet [hebrenjtë dhe jo hebrenjtë] një dhe i cili rrezoi barrierat dhe murin e armiqësisë.” Prandaj anagazhimi ynë ndaj paqes kërkon që ne t’i bëjmë ballë çdo sfide e cila mund të sjellë luftën.

Unë e konsideroj këtë gjë si parësore për misionin tonë si udhëheqës fetarë. Ne mburremi me harmoninë tonë ndërfetare, por nuk duhet kurrësi ta marrim të mirëqenë atë. Le të mos qëndrojmë

duarkryq për shkak se jemi duke jetuar paqësisht me njëri tjetrin, pasi nuk kemi garanci se jemi imunë ndaj çdo lloj rreziku.

Për këtë arsye, e konsideroj shumë të rëndësishëm faktin se duhet të kontrollojmë ekstremizmin dhe elementët e rrezikshëm brenda komuniteteve tona fetare. Ndoshta, deri tani, ne kemi theksuar nevojën për të kontrolluar elementët fundamentalistë dhe kemi ngecur në këtë përpjekje. Por ne duhet të theksojmë akoma më shumë nevojën për të edukuar modele paqësore dhe të ndërtojmë rrugën për një të ardhme më të sigurt dhe më harmonike ndërmjet komuniteteve fetare. Për këtë unë sugjeroj katër hapa:

Së pari, të gjithë ne të krishterë e myslimanë, duhet t'i edukojmë njerëzit që në fëmijëri që të respektojnë dinjitetin e çdo njeriu. Si Bibla edhe Kur'ani i kushtojnë një rëndësi të veçantë njeriut dhe dinjitetit të tij që në krijim, dhe përshkruajnë qenien njerëzore si një krijesë të veçantë që ka një marrëdhënie të veçantë me Zotin, Krijuesin. Jeta e gjithsecilit është e shenjtë dhe askush nuk ka të drejtë të ndikojë mbi dinjitetin apo të drejtat e një personi tjetër (duke përfshirë këtu edhe lirinë e besimit). Këtë pikë duhet ta kuptojnë dhe vlerësojnë dhe mësuesit në shkollat publike dhe jo publike.

Së dyti, duhet me çdo kusht, të shmangim format e ndërrimit të fesë, që do të thotë të mos ushtrojmë presion tek njerëzit që ata të pranojnë fenë tonë. Një formë e këtij fenomeni që është shumë e përhapur masivisht nëpër sekte nënkupton trokitjet në dyert e familjeve të cilat ata nuk i njohin aspak, duke u përpjekur t'i tregojnë atyre se besimi i tyre është i gabuar dhe më pas i prezantojnë me doktrinën e sektit të tyre, ndonjëherë duke e prezantuar sektin e tyre si feja që mund t' shërojë nga sëmundjet fizike.

Së treti, ne i kërkojmë autoriteteve të kenë më shumë kujdes për të evituar çdo formë diskriminimi ndërmjet feve dhe komuniteteve të ndryshme. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ne nenin e 10, paragrafin e 3 shpreh: “Shteti njeh barazinë midis të gjitha komuniteteve fetare”. Personat me pozitë duhet ta respektojnë me përpikmëri këtë normë, në mënyrë që mos gabojnë të tregojnë asnjë formë diskriminimi ndaj feve zyrtare të njohura nga shteti.

Se katërti, ne si udhëheqës të komuniteteve tona, duhet të tregojmë solidaritet për bashkësitë e tjera fetare nëse ndonjëra prej tyre gjendet para një sulmi terrorist apo ndonjë padrejtësie të qartë. Mendoj se ne kemi përcjellë mesazhe pozitive tek njerezit tanë, në momentin kur si Këshill Ndërfetar kemi dhënë deklarata të përbashkëta gjatë kohës kur dy akte të tmerrshme terroriste ndodhën në Zelandën e Re kundër myslimanëve dhe në Sri Lanka kundër të krishterëve. Njerëzit kanë nevojë pikërisht për këtë, të ndjejnë se ka solidaritet mes nesh.

Pra le të mos jemi thjesht rojtarët e paqes por dhe profetë dhe apostuj të saj në të gjithë botën.